

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**

**FAKULTETI JURIDIK**

**STUDIME POSTDIPLOMIKE-MASTER CIVIL DHE PRONËSOR**



## **Abstarkt i punimit të diplomës**

Servitutet në të drejtën romake dhe aspektet krahasuese me të drejtën pozitive në  
Kosovë dhe Shqipëri

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Bedri Bahtiri

Kandidat-ja:

Sidorela Xh.Kryeziu

Prishtinë, 2021

” Servitutet në të drejtën romake dhe aspektet krahasuese me të drejtën pozitive në Kosovë dhe Shqipëri”

Qëllimi i këtij studimi fokusohet në analizimin dhe shtjellimin e detajuar të servituteve. Çështja është analizuar duke paraqitur servitutet në aspekt historik dhe krahasimor që nga e drejta romake e gjërë tek e drejta pozitive në Kosovë dhe Shqipëri. Arsyet e trajtimit të këtij studimi janë; kushtet në të cilat janë krijuar servitutet, mënyra se si evoluon si dhe trajtimi dhe analizimi i tyre në të drejtën pozitive.

Është shqyrtuar në mënyrë analitike përkufizimin e konceptit të servitutit, kushtet në të cilat u krijua, ndikimi i saj i hershëm e vazhdues, veçoritë që shfaqti dhe kompleksiteti që e karakterizoi. Shqyrtimi i servituteve është bërë duke u bazuar së pari në të drejtën romake, e pastaj në legjislacionin shtetëror të Republikës së Kosovës si dhe të Shqipërisë, që është aktualisht në fuqi, poashtu edhe në shtjellimin e rasteve nga praktika gjyqësore. Punimi i masterit i përmban gjithësej 73 faqe. Punimit është i ndarë në *tre kapituj të veçantë*, duke i dhënë hapësirë në këtë mënyrë shqyrtimit sa më të mirë të servituteve, si dhe analizimin dhe krahasimin me të drejtën pozitive në Kosovë dhe Shqipëri.

*Në kapitullin e parë*, është bërë shqyrtimi mbi servitutet në kohë dhe hapësirë, analizë mbi përmbajtjen, vendin si e drejtë sendore dhe nocioni i servituteve, përkufizimet e përgjithshme edhe nocioni i servituteve si dhe burimet juridike të servituteve. Është paraqitur koncepti i servituteve në të drejtën romake. Mënyra se si janë krijuar servitutet, llojet e servituteve, parimet dhe rregullat e servituteve si dhe shuarja e tyre. Pastaj është vazhduar me konceptimet tradicionale të konceptit të uzufuktit në të drejtën romake, karakteri i uzufuktit, objekti, krijimi, mbrojtja e uzufuktit dhe shuarja e uzufuktit. Në aspekt analitik është trajtuar edhe përdorimi (usus) si dhe e drejta e banimit (habitatio) sipas të drejtës romake.

*Në kapitullin e dytë* është trajtuar çështja e servituteve në të drejtën pozitive në Kosovë. Parimet dhe llojet e servituteve, poashtu janë shtjelluar servitutet sendore në mënyrë të gjërë duke përfshirë objektin, subjektet e servituteve sendore, vëllimin e tyre, fitimi dhe shuarja si dhe mbrojtja e servituteve sendore. Janë shtjelluar servitutet personale. Në mënyrë të detajuar është trajtuar frutgëzimi (uzufukti), të drejtat dhe detyrat e gëzuesit të fryteve, krijimi dhe shuarja e frutgëzimit (uzufuktit). Është trajtuar edhe çështja e frutgëzimit në të drejta. Më tej është paraqitur përdorimi

(usus) dhe e drejta e banimit (habitatio). Pastaj, në këtë kapitull është paraqitur kohëzgjatja dhe mbrojtja e servituteve personale.

*Në kapitullin e tretë është bërë një analizë e servituteve sipas Kodit Civil të Shqipërisë, servituteve detyruese dhe vullnetare, mënyra ushtrimit të servituteve, shuarja dhe mbrojtja e servituteve. Pastaj është shqyrtuar edhe uzufukti, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga uzufukti si dhe mbarimi i uzufuktit. Pastaj është analizuar e drejta e banimit (habitatio) dhe e drejta e përdorimit (usus). Në vazhdim është bërë një vështrim analitik mbi praktikën gjyqësore në Kosovë dhe Shqipëri, në lidhje me servitutet. Punimi i masterit përmban *konkluzionet*, ku janë paraqitur arrijtjet e hulumtimit lidhur me servitutet.*

Në fund të punimit është prezantuar literatura e përdorur, tekstet, punimet profesionale, ligjet, si dhe kodi i përdorur. Literatura është shfrytëzuar nga autorë vendorë dhe ndërkombëtarë. Mbështetje kanë qenë ligjet e vendit tonë që zbatohen në të drejtën pozitive në Republikën e Kosovës si dhe ato në Republikën e Shqipërisë.